# Zëvendëskryetarët e Komunave për Komunitete (ZKKK-të) (janar - shtator 2017)*

Zëvendëskryetari i Komunës për Komunitete është mekanizëm mbrojtës lokal i detyrueshëm në komunat ku një komunitet pakicë përbën së paku 10% të popullsisë së komunës. Gjithashtu, këta mekanizma mund të krijohen edhe në komunat me më pak se 10% të komuniteteve, me vendim të kuvendit komunal. Mandati i ZKKK-së është të ofrojë këshilla dhe udhëzime për Kryetarin e Komunës për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet, si dhe përfaqëson të gjitha komunitetet me vendbanim në atë komunë. Kandidati për ZKKK propozohet nga Kryetari i Komunës dhe miratohet nga kuvendi komunal.
Dokumentet kyçe që rregullojnë themelimin dhe mandatin e ZKKK-ve janë ligji për vetëqeverisjen lokale (nr. 03/L-040, 2008), Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të zëvendëskryetarëve të komunave dhe Termat e Referencës për ZKKK-të.

*Mandati i ZKKK-së skadoi pas zgjedhjeve lokale në tetor 2017.

## Themelimi

ZKKK-të janë themeluar në 14 komuna**:

| | |
|---|---|
| Fushë Kosovë | Ferizaj |
| Graçanicë | Leposaviq* |
| Kllokot | Lipjan* |
| Novobërdë | Mamushë* |
| Prizren | Mitrovicë* |
| Shtërpcë | Obiliq* |
| | Zubin Potok* |
| | Zveçan* |

* Pozita e ZKKK-së nuk është e obligueshme por megjithatë është themeluar.
** Në Dragash, kjo pozitë nuk është themeluar përkundër pranisë së më shumë se 10% të komuniteteve në komunë.

## Komuniteti i ZKKK-ve




## Gjinia e ZKKK-ve




* Mamushë dhe Prizren

## Përqindja e ZKKK-ve që i kryejnë detyrat siç përcaktohet në legjislacion

Dhënia e këshillave dhe udhëzimeve për kryetarët e komunave në çështjet e komunitetit




Mbështetje për kërkesat e komuniteteve në organet komunale




Puna në terren me komunitete dhe/apo promovimi i aktiviteteve të punës në terren nga komuna




Siguron që ekzekutivi komunal zbaton me efekt projektet/ aktivitetet/ politikat/ rregulloret që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve




Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve




Promovimi i ndërtimit të besimit ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve komunale




Siguron që fonde të mjaftueshme parashihen në buxhet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejta të komuniteteve dhe se nevojat dhe interesat e komuniteteve merren parasysh gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit




Po Jo

Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në vendimmarrjen publike dhe në proceset e qeverisjes dhe institucioneve. Për të ndihmuar në këtë drejtim, OSBE-ja monitoron rregullisht performancën e mekanizmave komunalë të mbrojtjes së komuniteteve. Këto letra informuese kanë për qëllim tu ofrojnë institucioneve përkatëse treguesit që mund t'ju ndihmojnë t'i identifikojnë zbrazëtirat dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.

osbe
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**

# Zëvendëskryesuesit e Kuvendit Komunal për Komunitete (ZKKK-ja) (janar - shtator 2017)*

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete është mekanizëm mbrojtës lokal i detyrueshëm nëse komunitetet përbëjnë së paku 10% të popullsisë në komunë. Ai ka mandat t'i shqyrtojë të gjitha ankesat e anëtarëve të komuniteteve lidhur me shkeljet e të drejtave të tyre përmes akteve ose vendimeve të kuvendit komunal dhe është përgjegjës për t'i referuar shkeljet e tilla në kuvendin komunal. ZKKKK-ja mund të kërkojë rishqyrtimin e aktit ose vendimit. Përveç kësaj, në rrethana specifike, ai/ajo mund të paraqesë në Gjykatën Kushtetuese akte ose vendime të cilët konsiderohen se shkelin të drejtën e garantuar me Kushtetutë. Kjo pozitë nuk mund të themelohet në komunat me më pak se 10% të komuniteteve, dhe këtë pozitë e ka anëtari i komunitetit që ka marrë numrin më të madh të votave nga lista e hapur e kandidatëve për zgjedhjet komunale.

Dokumentet kyçe që rregullojnë themelimin dhe mandatin të ZKKKK-ve janë Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (nr. 03/L-040, 2008) dhe Udhëzimet për ZKKKK-të.

*Mandati i ZKKKK-së skadoi pas zgjedhjeve lokale në tetor 2017.

## Themelimi

ZKKKK-të janë themeluar në 9 komuna*:

| | |
|---|---|
| Dragash | Leposaviq** |
| Fushë Kosovë | Mitrovicë** |
| Kllokot | Zubin Potok** |
| Novobërdë | |
| Prizren | |
| Shtërpcë | |

* Në Graçanicë, kjo pozitë nuk është themeluar përkundër arritjes së pragut prej 10% për komunitete.

** Paqartësi lidhur me themelimin e pozitës për shkak të mungesës së rezultateve të regjistrimit të popullsisë në këto komuna.

## Komuniteti i ZKKKK-ve




## Përqindja e ZKKKK-ve që i kryejnë detyrat siç përcaktohet në legjislacion

Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve




Në takimet dhe punen e kuvendit komunal adreson shqetësime dhe çështje që kanë të bëjnë me nevojat e komuniteteve




Rishikon ankesat që parashtrohen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë ***




*** Hapi i ardhshëm për rastet e tilla do të ishte që ZKKKK ta referojë çështjen në kuvendin komunal për rishqyrtim të aktit ose vendimit. Nëse kuvendi komunal vendos të mos rishqyrtojë aktin ose vendimin e tij ose ZKKKK-ja konsideron se edhe pas rishqyrtimit, akti apo vendimi përbën shkelje të së drejtës së garantuar me Kushtetutë, atëherë ZKKKK e parashtron çështjen drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese.

Po Jo

## Gjinia e ZKKKK-ve




* Kllokot

## Funksionimi dhe Raportimi

Po Jo

ZKKKK-të me plane të punës në vitin 2017




ZKKKK-të që kanë raportuar mbi punën e tyre në kuvendin komunal më 2017




osbe
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Kosovë**